

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, sekretaren juridike Violeta Zeqiri në lëndën penale kundër të akuzuarit B.R., për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së, sipas propozim akuzës të Prokurorisë Komunale në Ferizaj PP.nr.2281/2011 të datës 27.02.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit, mbrojtësja e të akuzuarit av, E.H.V. me autorizim, me datë 07.06.2016, shpall dhe publikisht komunikon,

**A K T G J Y K I M**

**Kundër të akuzuarit:**

**B.R.**, nga Ferizaj, rr. ” .....” nr..... data e lindjes..... në të njëjtin vend, nga i ati I. dhe e ëma M. gjinisë A., i martuar, ka të kryer shkollën e fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së**

**LIROHEN NGA AKUZA**

Sepse gjatë viteve 2010 dhe 2011 në kafiterin “.....” qe gjendet ne rrugën “.....” në Ferizaj, pronë e të dëmtuarit D.G.1 nga Ferizaj gjatë përkujdesjes per pasurinë e të dëmtuarit ,ka keqpërdorur autorizimet e tije si bankier me qellim qe vetes dhe personit tjetër ti sjell dobi pasurore te kundërligjshme, ne atë mënyre qe derisa nuk ishin prezent pronaret e lokalit gjatë përkujdesjes për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e punëve duke përfshirë edhe pranimin e

pazarit ditor ne bashkëpunim edhe me personat tjerë nuk e kishte dorëzuar shumën e mbledhur por kishte shmangur përafërsisht 70 deri 80 euro ne dite e sipas te dëmtuarit per dy vite e kishte dëmtuar atë ne total prej 70.000 €

- **meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së**

Të dëmtuarit D.G.1 dhe D.G.2 nga Ferizaj Rr.’’.....’’nr..... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku i procedurës**

- Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.nr.2281/2011 të datës 27.02.2012, kundër të akuzuarit B.R. , për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 12.05.2016, 31.05.2016 dhe 07.06.2016, kurse Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit.

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

**I akuzuari B.R. deklaron:** në shqyrtimin gjyqësor por edhe ne seancat tjera ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilin e ngarkon akuza, i cili ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale por e pranon faktin se ka punuar ne kafiterin “.....” si shankist i cili kishte pranuar faktin se i ka numëruar tikat dhe ju ka dorzuar pronarëve të cilët ne disa raste kur kanë dyshuar i kanë rinumëruar këta tika edhe pronaret e kafiteris.

**Mbrojtësja e autorizuar e të akzuarit B.R., av. E.H.V. në fjalën e sajë përfundimtare** ka deklaruar: se nga prova e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar në kohen, vendin dhe mënyrën siq është përshkruar në aktakuzë e Prokurorisë së shtetit se ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së, Ligjdhënësi në mënyrë shumë strikte dhe te qarte e ka precizuar se për të ekzistuar një vepër penale e kësaj natyre e ne radhe te pare kryes i kësaj vepre mund te jete vetëm personi i cili është i autorizuar te përfaqësoj interesat e ndajnë personi apo te përkujdset për pasurin e tije. Duke theksuar se siq është provuar dhe argumentuar ne këtë shqyrtim gjyqësor i mbrojturi im ka punuar ne kafiterin “.....” si shankist e cili pozitë e punës se tije është provuar edhe gjate dëgjimit te dëshmitareve por edhe me kontratën e ofruar nga palët e dëmtuara. Edhe gjate deklarimit te dëmtuarve është vërtetuar se ne këtë kafiteri kanë punuar zakonisht 3 deri 4 persona dhe gjithherë prezent kanë qene edhe njeri nga pronaret e kafiteris. Sa i përket deklaratave te dhëna ne procedurën hetimore – ne stacioni policor por edhe gjate shqyrtimeve gjyqësore ne cilësinë e dëshmitareve: te dëmtuarve D.G.1 ku i njëjti gjate gjithë kohës ka potencuar se mbrojturi im ka qene përgjegjës i aparatit te kafes dhe po ashtu afër tije ka qene e vendosur ka qene objekti ne forme gozhde ku janë vendosur nga kamarjeret tikat apo kuponat e marrjes se pijeve me te cilat i kanë shërbyer musafiret.sa i përket pazarit ditor i njëjti ka deklaruar se te hollat e pazarit ditor i ka marrur vete apo vëllai i tije D.G.2 pas numërimit te tikave nga shankistet e si shankist ne kafiterin e tyre nuk ka qene vetëm B.R. por edhe N.B. mirpo ka pasur raste kur edhe kur këta shankista i kanë numëruar tikat, pronaret e kafiteris i kanë rinumëruar edhe një here tikat dhe gjithherë shuma nga tikat është përputhur me pazarin ditor te dorëzuar nga ana e kameriereve. **Nga dëshmia e dëshmitarit A.S.:** ka demantuar deklaratën e dhënë në polici dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 28.05.2013 po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.06.2016, ti cilit ju është tërheq vërejtja nga prokurori i shtetit lidhur me pasojat ligjore të dëshmisë së rreme e po ashtu edhe nga gjyqtarja. I njëjti ka potencuar se dëshminë të cilën e kishte dhënë në polici me të cilën e

ka ngarkua B.R., ka qen dëshmi e ndikuar dhe e shantazhuar nga pronaret e kafiterisë. Ka kërkuar zbatimin e nenit 364 par. 1 dhe 1.3 të KPPRK-së, ti jepet aktgjykim lirue.

### **3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari B.R., nuk kanë pranuar fajësinë për asnjë pikë të dispozitivit të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;
- Nga deklaratat e të dëmtuarve
- Nga leximi i deklaratës për dëshmitarin N.B.
- Deklaratat e dëshmitarëve:

### **Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Nga dëshmitë e këtyre të dëmtuarve-dëshmitarëve: D.G.1, D.G.2, leximi i deklaratës së N.B., B.S., M.R. dhe A.S..

**Dëshmia e te dëmtuarit- dëshmitarit D.G.1:** në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka qen bashkëpronar i lokalit afarist Kafiteria” ..... “e cila gjendet në Ferizaj së bashku me vëllaun e tij D.G.2 duke theksuar se gjat punës së tyre si pronar gjithherë njëri prej tyre i kishin mbajtur një ndërrim të punës, duke shtuar se B.R. ka qene personi i cili ka qene përgjegjës i aparatit te kafes, po ashtu dhe ky ka theksuar se afër aparatit te kafes ka qene një gozhde ku janë vendosur nga kamerieret tikat apo kuponat e marrjes se pijeve ne te cilën i kanë shërbyer musafiret.sa i përket pazarit ditor i njëjti ka deklaruar se te hollat e pazarit ditor i ka marrur vete ose vëllai i tij D.G.1 pas numërimit te tikave nga shankistete dhe ky ka potencuar faktin se ne cilësinë e shankistit ka punuar edhe N.B.. Dyshimet rreth mungesës së pazarit ditor ( keqmenagjimit) ka cituar se i kishin lindur nga dëgjimi i një incizimi që ju kishte ofruar nga B.S. dhe M.R., në të cili është ndëgjuar se punëtorët mbas mbarimit të punës si i kishin ndarë paratë dhe prezent ka qen edhe B.R..

**Dëshmia e dhëne nga dëshmitari B.S.:** e cila është mbështetur nga dëshmitari edhe deklaratën e dhëne ne polici po ashtu edhe ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur 07.05.2013, 28.05.2013 dhe 06.06.2013 dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.06.2016, ka theksuar se B.R. ka qene përgjegjës vetëm për përgatitjen e kafes, se gjate ndërrimit te tije ka qëndruar pran aparatit te kafes ka përgatitur porosit e kërkuara nga kamerieret për te shërbyer mysafiret me kafe. Për të akuzuarin - B.R. ka pohuar se nuk ka qene mëngjër apo përgjegjës i tyre dhe se gjate gjithë kohës ne kafiteri kanë qëndruar njeri nga pronaret e saje D.G.1 dhe D.G.2. Ka pohuar dhe faktin se ka pasur raste se vet pronaret e kafiteris ju kanë ofruar një ‘‘takam ‘‘ me porosi për ti shërbyer musafiret e caktuar këtë porosi e kanë pasur si dhuratë nga pronaret dhe ne këtë rast nuk kanë shënuar kupon apo teka, duke shtuar se B.R. nuk ka keqpërdorur.

**Dëshmia e dhëne nga M.R.:** i cili ka sqaruar menagjimin e punës ne kafiteri e ka bere D.G.1 dhe D.G.2 pronar te kësaj kafiterie, ndërsa B.R. ka qene vetëm shankist i cili është kujdesur për aparatit e kafes, e ka përgatitur kafen ne baze te porosive për ti shërbyer mysafiret dhe unë në bazë të porosive ua kam shpërndarë musfirëve duke potencuar se B.R. nuk ka keqpërdorur.

**Dëshmia e dhëne nga dëshmitari -A.S. –** ka demantuar deklaratën e dhënë në polici në shqyrtimin gjyqësor të datës 28.05.2013 ti cilit ju është tërheq vërejtja nga prokurori i shtetit lidhur me pasojat ligjore të dëshmisë së rreme e po ashtu edhe nga gjyqtarja. I njëjti ka potencuar se dëshminë të cilën e kishte dhënë në polici me të cilën e ka ngarkua B.R., ka qen dëshmi e ndikuar dhe e shantazhuar nga pronaret e kafiterisë, e veçanërisht duke nga D.G.1 i cili kur ka shkuar në polici për të dhënë deklaratë më ka thënë se ‘‘ Target B.R.’’ dhe i njëjti ka potencuar se nga frika se nuk ja bëjnë pagesën për 3 paga mujore, ka dhënë dëshminë e cila nuk është e vërtetë duke shtuar se është përdorur për dhënien e kësaj deklarate e cila ka qen si rezultat i shantazhit të bërë nga pronarët e kafiterisë. Prandaj me gjith këto dëshmi të dhëna në këtë gjykatë, nga dëshmitë e të dëmtuarve – dëshmitarëve, nuk është provuar dhe nuk është vërtetuar se mbrojturi i im e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, sepse të gjithë dëshmitarët e dëshmuar se B.R. nuk ka qen përgjegjës për menagjimin dhe kontrollimin e punëve në kafi terin ‘‘.....’’ por ka qen vetëm një shankist i cili ka qëndruar pranë aparatit të kafes e vendosur në shankun e kafiterisë. Shanku i i kafiterisë ka pasur një gjatësi prej 6 metrave, dhe se aparati ka qen i vendosur në një rënë në një rënë skaj të dhe se gjatë punës së tij ne aparat B.R. e ka pasur shpinën e kthyer nga pjesa tjetër e shankut dhe lidhur me këtë nuk ka pasur mundësi ta

kontrolloj prej së largu punën e shankisteve tjerë duke theksuar se B.R. nuk ka bërë keqpëdorim të pazarit ditor.

**Dëshmia e dhënë nga i dëmtuari - dëmtuari D.G.2** në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka qen bashkëpronar i lokalit afarist Kafiteria” ..... “e cila gjendet në Ferizaj së bashku me vëllaun e tij D.G.1, ka deklaruar në procedurën hetimore po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor se B.R. ka qene personi i cili ka qene përgjegjës i aparatit te kafes, dhe afër aparatit te kafes ka qene një gozhde ku janë vendosur nga kamerieret tikat apo kuponat e marrjes se pijeve ne te cilën i kanë shërbyer musafiret. Sa i përket pazarit ditor i njëjti ka deklaruar se te hollat e pazarit ditor i ka marrur vete ose vëllai i tije D.G.1 pas numërimit te tikave nga shankistete dhe ky ka potencuar faktin se ne cilësinë e shankistit ka punuar edhe N.B.. Ka theksuar se besimin e kishte tek B.R. për menagjim të punës dhe në stacionin policor ka dëshmuar vetëm për B.R. dhe jo për punëtorët tjerë, duke shtuar se ka pasur kamera për kontrollimin e punëtorëve në kafiteri

Gjykata bëri zbatimin e provave dhe pas vlersimit të të tyre një nga një si dhe në lidhmërinë e tyre reciprokekonform nenit 361 1par. dhe 2 të KPPK-së, dhe vërtetoi gjendjen faktike .

### **Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Nga dëshmitë e këtyre të dëmtuarve: Deklaratat kontradiktore në mes të dëmtuarve D.G.1 dhe D.G.2 në njërën anë dhe të akuzuarit në anën tjetër, si dhe të dëshmitarëve. Të dëmtuarit cilët kanë pohuar në procedurën hetimore por e dhe në shqyrtimet gjyqësore, se B.R. ka qen menagjer i punës në kafiterin “ ..... “, një fakt i tillë nuk asht vërtetuar nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët B.S., M.R. dhe A.S. dhe nga leximi i deklaratës së dëshmitarit N.B., të dhënë në procedurën hetimore. Gjykata vlerëson se nga këto dëshmi nuk mund të bihet ndonjë konkludim inkriminues përkitazi me të akuzuarin,

Padyshim se vlerësimin më të rëndësishëm Gjykata do ta bëj përkitazi me dëshminë e të dëmtuarve dhe atë për arsyet si në vijim:

- se të njëjtat nuk ka qenë konsistente në dëshmitë e tyre gjatë fazës të procedurës hetimore penale si dhe në shqyrtimin gjyqësor,

- Dëshmia e dëshmitareve B.S., M.R. me të cilat është vërtetuar pozita e punës së B.R. i cili ka qenë vetëm shankist e jo edhe menagjer i punës në këtë kafiteri “.....”.

- Nga leximi i deklaratës së N.B. me të cilin është vërtetuar se i njëjti kishte deklaruar se gjatë orarit të punës së tij kishte pasur keqpërdorime, por në orarin e punës së B.R. nuk e ka vërtetuar këtë fakt pasi që i njëjti ka deklaruar se nuk e di se a ka pasur keqpërdorime nga ana e B.R..

- Dëshmia e dëshmitarit A.S. dhe përfundimisht nga kjo dëshmi është konstruktuar skeleti i akuzës ndaj të akuzuarit, e njëjta është demantuar në shqyrtimin gjyqësor të mëhershëm të datës 07.05.2016 si dhe në shqyrtimin gjyqësor 12.05.2016.

Andaj nga këto arsye është më se e nevojshme që kjo dëshmi të vlerësohet në mënyrë sistematike në të gjitha fazat e procedurës penale dhe assesi në mënyrë fragmentare nga njëra fazë në tjetrën.

Dëshmia e të dëmtuarve në fazën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata nuk i mori si të besueshme dhe atë nga faktet që do ti paraqesim në vijim:

- se në tërë fazat e procedurës i dëmtuari D.G.1 i cili ka theksuar se në çdo ndërrim të punës ishin vjedhur nga 80 deri në 90 euro dhe në të dy ndërrimet ishin vjedhur nga 180 euro duke konsideruar se parat ishin vjedhur nga të gjithë punëtorët dhe atë: B.R., N.B., M.R., B.S. dhe A.S..

Gjatë gjithë fazës së procedurës vërehet një dëshmi jo reale në lidhje me përshkrimin e kësaj vepre penale, pasi që sipas të dëmtuarve D.G.1 dhe D.G.2, të gjithë kishin keqpërdorur parat në kafiterinë, ku dëmi është konsiderua deri në 70.000 / shtatëdhjetë mijë euro / por i njëjti ka akuzuar vetëm B.R. në pretekstin se të dëmtuarit kishin pasur besim më të madh te B.R., *mirëpo sa i përket dëshmive nga të dëmtuarit nuk qëndrojnë për shkak se gjykata ka vërejtur se të dëmtuarit nuk kanë arritur ta bëjë përshkrimin e pozitës së punës së B.R., duke ofruar gjykatës edhe kontratën e punës së datës 10.12.2009, ku është e specifikumë profesioni **Banakier** në kafiterin “.....”*

Andaj, Gjykata vlerëson se pretendimet se është kryer një veprë e tillë janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

### **Vlersimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Gjithsesi për të bërë një analizë të gjitha provave të shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme është e nevojshme të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit e cila asnjëherë nuk duhet të vlerësohet në mënyrë fragmentare nga provat tjera, të rikujtojmë se i akuzuari gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka mohuar kryerjen e veprës penale, por se natyrisht në raste të tilla kur bëhet fjalë për një veprë të kësaj natyre është plotësisht e pa besueshme që nga i akuzuari të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj qeshje.

Duke bërë analizën edhe nga Mbrojtësja e të akuzuarit Av E.H.V. në të gjitha shqyrtimet gjyqësore edhe në fjalën përfundimtare po ashtu ka bërë përshkrimin se nga prova e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar në kohën, vendin dhe mënyrën siq është përshkruar në aktakuzë e Prokurorisë së shtetit se ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 par.1 të KPK-së, Ligdhënësi në mënyrë shumë strikte dhe te qarte e ka precizuar se për te ekzistuar një veprë penale e kësaj natyre e ne radhe te pare kryes i kësaj vepre mund te jete vetëm personi i cili është i autorizuar te përfaqësoj interesat e ndajnë personi apo te përkujdeset për pasurin e tije.

### **6. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit**

Po ashtu, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, i cili në fjalën e tij nuk e konkretizon qoftë edhe një veprim konkret të të akuzuarit B.R. pos që mbetet në tërësi pranë aktakuzës si në përshkrimin e dispozitivit dhe kualifikimit juridik të veprës penale.

Gjykata në mënyrë të posaçme ka vlerësuar fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit sa i përket kësaj pjese të aktgjykimi dhe ka gjetur se nuk është paraqitur asnjë e dhënë bindëse për kryerjen e kësaj vepre penale të paraqitur në fjalën përfundimtare.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë



duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. e në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara për këtë pjesë të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Në bazë të nenit 454 të KPPK-ës nëse konstatohen shpenzime eventuale të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.662/14 e datës 07.06.2016**

**Sekretarja juridike,**

**Violeta Zeqiri**

**Gjyqtarja individuale,**

**Hakile Ilazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.